



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

**VENDIM Nr 62 Datë 22.04.2020**

“Për shtyrjen e afatit të pagesës së Taksave dhe Tarifave Vendore për Bashkinë Dibër nga ana e subjekteve”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe ligjin Nr 9632 date 30.10.2006 “Per Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.124 datë 20/12/2019 “Për Miratimin e Paketës Fiskale për Taksat dhe Tarifat Vendore për vitin 2020”, miratuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër me nr. 1832/1 prot. datë 30.12.20219. Duke marrë parasysh situatën e krijuar për përhapjen e pandemisë nga COVID-19 propozojmë shtyrjen e afatit të pagesave për taksat dhe tarifat vendore deri ne Shtator. Subjektet e mbyllura te paguajne në Shtator 2020 ,subjektet e hapura do paguajnë rregullisht , si pasojë e kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19. Kërkojmë që në zbatim të aktit normativ nr.5 datë 17.03.2020 “Për një shtesë në aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”: Këshilli Bashkiak miratoi me **18** vota pro **1** votë kundër dhe **1** votë apstenim vendimin me ndryshime nga projekti :

VENDOSI:

- I. Shtyrjen e afatit të pagesës së Taksave dhe Tarifave Vendore për Bashkinë Dibër nga ana e subjekteve te mbyllura te paguajn në Shtator 2020 ,subjektet e hapura do paguajne rregullisht , si pasojë e kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.
- II. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Tatim Taksave pranë Drejtorisë Ekonomike në Bashkinë Dibër.
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

Sekretare Këshilli

Inva Trupja

Kryetar Këshilli

Sokol Sava

